

**Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete
Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik**

**Vlerësimi jo-adekuat i Rrethanave Lehtësuese dhe Rënduese
nga Gjykatat**

Edicioni 5

Korrik 2010

Vlerësimi jo-adekuat i rrethanave lehtësuese dhe rënduese nga gjykatat

Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) është i brengosur se praktikat jo-adekuate në dënim mund të përbëjnë shkelje të ligjit ndërkombëtar humanitar dhe kornizës ligjore në Kosovë. OSBE ka monitoruar raste kur gjykatat dështojnë të vlerësojnë rrethanat që janë relevante për zbutjen apo ashpërsimin e dënimit të veprës penale kur caktojnë dënimin për të pandehurit. Vlerësimi jo-adekuat i këtyre rrethanave lehtësuese apo rënduese ishin veçanërisht të dukshme kur gjykatat dënonin të pandehurit nën minimumet e parapara ligjore.

Gjykatat në Kosovë duhet të marrin parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese kur vendosin lidhur me dënim për një vepër penale. Kjo përfshin “shkallën e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryerësit, pranimin e fajit, rrethanat e tij personale të kryerësit dhe sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale.”¹ Edhe pse ligji specifikon një numër rrethanash që duhet të merren parasysh si përkatëse, kjo listë nuk është përfundimtare dhe gjykatat kanë për obligim të marrin parasysh rrethana tjera që konsiderohen të rëndësishme për caktimin e dënimit.²

Vendimet mbi dënime duhet të përfshijnë sqarime të arsyetuara mirë lidhur me rrethanat lehtësuese dhe rënduese përkatëse që ndikuan tek gjyqtari në rast.³ E drejta e të akuzuarit për vendim të arsyetuar është një ndër kushtet për gjykim të drejtë, për shkak se lejon të drejtën për të ushtruar ankesë. Kjo ja mundëson gjykatës së shkallës së dytë që ti shqyrtojë tërësisht gjetjet e gjykatës së shkallës së parë.⁴

Në Rekomandimet e veta të Komitetit të Ministrave nga Shtetet Anëtare Lidhur me Vazhdueshmërinë në Dënime, Këshilli i Evropë rekomandon që “gjykatat do të duhej që në përgjithësi të deklarohen lidhur me arsyet për vendosjen e dënimeve. Në veçanti, arsye të veçanta duhet të jepen kur caktohet dënim me burg. Çfarë njihet si ‘arsye’ është motivimi që lidh një dënim të caktuar me klasifikimin normal të dënimeve për llojin e krimit, dhe shkaqet e deklaruara për dënim.”⁵

¹ Neni 64(1), Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2003/25, 6 korrik 2003, me ndryshimet pasuese. Me 6 nëntor 2008, Kosova ka shpallur Ligjin Nr. 03/L-002 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës Nr 2003/25, që la ligjin përmbajtësisht të njëjtë me ligjin e vitit 2003, me vetëm një pjesë të shtuar për aranzhimet lidhur me deklaratimet për fajësi dhe ndryshimin e emrit të ligjit në Kodi Penal i Kosovës, prej këtu e tutje i referuar si KPK.

² Ibid.

³ Nenet 396(8), 402(1)(3) dhe 403(1)(12), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2003/26, 6 korrik 2003, me ndryshimet pasuese. Me 22 dhjetor 2008, Kosova ka shpallur Ligjin Nr. 03/L-003 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës Nr 2003/26, që la ligjin përmbajtësisht të njëjtë me ligjin e vitit 2003, edhe pse ishte shtuar një pjesë për aranzhimet lidhur me deklaratimin e fajësisë, një nen mbi kohëzgjatjen e paraburgimit policor ishte ndryshuar dhe emri i ligjit ishte ndryshuar në Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, prej këtu e tutje i referuar si KPPK.

⁴ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykimi i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33.

⁵ Këshilli i Evropës, Rekomandimi Nr. R(92)17 i Komitetit të Ministrave nga Shtetet Anëtare në Lidhje me Konsistencën në Dënime, 19 tetor 1992.

Kodi Penal i Kosovës (KPK) parasheh dënimet minimale dhe maksimale për secilën vepër penale. Kur ka rrethana veçanërisht lehtësuese që tregojnë se qëllimi i dënimit do të arrihej me një dënim më të butë, gjykata mund të zvogëlojë ndëshkimin nën dënimin minimal të paraparë me ligj nën rrethana tjera.⁶ Megjithatë, gjykata duhet ta arsyetojë vendimin e vet, dhe ta sqarojë autoritetin e vet kurdo që cakton dënim nën minimumin e paraparë të ofruar në kodin penal.⁷ Arsyetimi i pamjaftueshëm i gjykatës mund të jetë bazë për ankesë.⁸

Dështimi për ti vlerësuar në mënyrë adekuate rrethanat lehtësuese

OSBE ka monitoruar raste që nuk kanë demonstruar rrethanat lehtësuese. Megjithatë, gjykatat kanë shqiptuar dënime nën minimumin e paraparë, pa justifikuar vendimin në arsyetimet e veta.⁹ Në disa raste, vendimi thjeshtë i referohej ekzistimit të rrethanave lehtësuese pa vlerësuar rrethanat përkatëse që u perceptuan si lehtësuese për të arsyetuar dënimin nën minimumin e paraparë me ligj.

Me 14 tetor 2009, një gjykim fillojë pranë gjykatës së qarkut në Gjilan/Gnjilane kundër dy të pandehurve të rritur dhe dy tjerëve të mitur, të akuzuar për kidnapimin e një fëmije.¹⁰ Sipas KPK-së, vepra penale e kidnapimit parasheh dënimin me burg prej një deri në dhjetë vite. Katër të akuzuarit u shpallën fajtorë. Një i pandehur i rritur ishte dënuar me tre muaj ndërsa tjetri me gjashtë muaj dënim me burg. Masa edukative e mbikëqyrjes intensive nga autoriteti kujdestar¹¹ ishte vendosur ndaj dy të pandehurve të mitur. Dënimi i shqiptuar nga gjykata, veçanërisht kundër dy të rriturve, ishte nën dënimet minimale standarde, por aktgjykimi nuk ofroi vlerësim të rrethanave që do të mund ta autorizonin një dënim me burg të lehtë. Në aktgjykim si rrethana lehtësues përmendeshin sjellja e mirë e të pandehurve gjatë gjykimit, nivelet e tyre të edukimit dhe mungesa e dënimeve të mëhershme. Këto rrethana nuk duken të jenë “veçanërisht lehtësuese” për të arsyetuar dënimin nën kufijtë e paraparë me ligj. Megjithatë, prokurori nuk parashtroi ankesë kundër vendimit.

Me 13 tetor 2009, një gjykim filloi pranë gjykatës së qarkut në Gjilan/Gnjilane kundër një të pandehuri të akuzuar për veprën penale të abuzimit seksual të personave nën moshën 16 vjeçare.¹² Viktima ishte 15 vjeçare. Për këtë veprë

⁶ Neni 66 i KPK-së thotë, “[G]jykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit: 1) Kur ligji parasheh se dënimi i kryerësit mund të zbutet ose 2) Kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se edhe me dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit.”

⁷ Neni 66(2), KPK.

⁸ Nenet 396(8), 402 dhe 403, KPPK.

⁹ Neni 396(8), KPPK parasheh se “[k]ur i akuzuari dënohet me burgim, arsyetimi përfshin rrethanat të cilat gjykata i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit. gjykata veçanërisht arsyeton se në cilat shkaqe është bazuar kur ka konstatuar se ka të bëjë kur ... ka konstatuar se është e nevojshme të ulë apo të heqë dënimin.”

¹⁰ Nenet 159(2) dhe 23, KPK.

¹¹ Neni 22, Ligji Penal për të Mitur, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2004/8 mbi Ligjin Penal për të Mitur në Kosovë, 20 prill 2004. Masa edukative nuk përfshin dënim me burg, por obligim prindëror (ose të kujdestarit) për të monitoruar veprimet e fëmijës për së afërmi.

¹² Neni 198(1), KPK.

parashihet dënimi me burg për një deri në dhjetë vite. Megjithatë, i pandehuri u dënua me tre muaj burg. Gjykata morri parasysh si rrethana lehtësuese sjelljen e mirë të të pandehurit gjatë gjyqimit, deklarin e fajësisë, pendimin e thellë që e shprehi gjatë dëgjimit, kushtet e vështira ekonomike në të cilat jeton, që është i martuar dhe baba i pesë fëmijëve. Vendimi i gjykatës nënvizoi se me shqiptim e këtij dënimi “qëllimi i ndëshkimit [...] do të arrihet”.

Në këto raste, gjykata dështoi të vlerësojë, madje edhe të identifikojë rrethanat e veçanta lehtësuese që do të sugjeronin se qëllimi i dënimit do të mund të arrihej përmes një dënimi më të lehtë.

Nuk ka pasur garanci, siç kërkohet me Nenin 66 të KPK-së se ka pasur kushte që kanë lejuar zbutjen e dënimit, ose se zbutja e dënimit ishte brenda kufijve të autorizuar me Nenin 67 të KPK-së.

Dështimi për ti vlerësuar në mënyrë adekuate rrethanat rënduese

Gjykatat nuk e kanë pasur të vështirë ti vlerësojnë vetëm rrethanat lehtësues, por kanë pasur vështirësi të ngjashme edhe me rrethanat rënduese.

Me 21 gusht 2009, stacioni policor në Pejë/Peć bëri një kallëzim penal kundër një të pandehuri 34 vjeçar për dhunim¹³ të një vajze 11 vjeçare. Dhunimi i viktimës nën moshën 16 vjeçare bart dënim me burg prej pesë deri në njëzet vite. Edhe pse ka pasur marrëdhënie seksuale në mes të pandehurit dhe fëmijës, aktakuza e ngritur me 28 shtator 2009 ri-kualifikoi veprën si abuzim seksual të personit nën moshën 16 vjeçare.¹⁴ Dënimi me burg për veprën e rikualifikuar është prej një deri në dhjetë vite. Megjithatë, në veprën e rikualifikuar, kur kryesi shkaktonte “lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë të shëndetit mendor dhe fizik të personit” dënimi me burg është më i gjatë, prej tre deri në pesëmbëdhjetë vite.¹⁵ Eksperti mjekësor dëshmoi se fëmija pësoi çrregullim të stresit post-traumatik nga ajo që ndodhi, dëshmi që viktimja pësoi çrregullim serioz të shëndetit të saj mendor. Me 23 nëntor 2009, gjykata e qarkut në Pejë/Peć e dënoi të pandehurin me një vit e gjashtë muaj burgim. Gjykata nuk gjeti asnjë rrethanë rënduese. Arsyetimi nuk përfshinte simptomat post-traumatike emocionale dhe të sjelljes të shëndetit mendor që shfaqte fëmija.

Gjykata dështoi në vlerësimin adekuat të rrethanave rënduese para caktimit të dënimit. Arsyetimi që nuk adreson lidhjen e shkakut ndërmjet krimit dhe pasojës, në këtë rast në rezultimin e sindromit të stresit post-traumatik, dështon që të plotësojë standardet minimale të një vlerësimi adekuat të rrethanave përkatëse, që është e domosdoshme para shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit.

Me 14 tetor 2009, OSBE ka monitoruar një rast pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë/Priština ku i pandehuri ishte dënuar sipas Nenit 198(1) të KPK-së, për abuzim seksual të personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare. Eksperti

¹³ Neni 193(4), KPK.

¹⁴ Neni 198(1), KPK.

¹⁵ Neni 198(5)(2), KPK.

i shëndetit mendor dëshmoi se viktimat vuan nga dëmtime mendore që prej lindjes. Arsyetimi me shkrim i gjykatës nuk ka vlerësuar se a kanë qenë rrethana rënduese në këtë rast të abuzimit seksual, mosha dhjetë vjeçare e viktimës, apo dëmtimet e saj mendore, e as nuk ka marrë fare parasysh këta faktorë kur ka caktuar dënimin për të pandehurin. Gjykata, megjithatë ka marrë parasysh si rrethanë lehtësuese mungesën e dosjes së mëparshme kundër të pandehurit.

OSBE ka vërejtur se në shumë raste gjyqtarëve u mungon kuptimi i duhur se si rrethanat e ndryshme mund ose duhet të ndikojnë në vendimin mbi dënimin. Edhe pse gama e rrethanave lehtësuese dhe rënduese është e gjerë, dhe gjykatat kanë lirinë e veprimit se si ti aplikojnë këto në dënime, janë disa faktorë që qartazi duhet apo nuk duhet të merren parasysh. Një rrethanë lehtësuese apo rënduese duhet të jetë relevante me veprën penale apo me rrethanat personale të kryesit. Referimet standarde në, apo numërimi i faktorëve lehtësues apo rëndues ndonjëherë çon në referim të rrethanave që nuk janë relevante për rastin specifik.¹⁶ Një faktor i tillë lehtësues, të cilit shpesh gjykatat i referohen, janë kushtet ekonomike të kryesit. Është vështirë të shihet se si kushtet ekonomike të kryesit mund të kenë çfarëdo ndikimi, lehtësues apo rëndues mbi vendimin e gjykatës për dënimin e veprave seksuale siç janë dhënë në shembujt e mësipërm.

Gjyqtarët kanë tendencë, përfshirë edhe në rastet që kanë të bëjnë me anëtarët më të ndjeshëm të shoqërisë, të aplikojnë më shumë rrethana rënduese se sa lehtësuese. Në dy rastet e referuara më sipër, viktimat kanë qenë vajza të mitura. Duke përdorur rrethana lehtësuese e jo edhe rënduese për kryesit të dhunës seksuale kundër vajzave të mitura dhe me paaftësi mendore, ngrit çështjen serioze të politikave lidhur me atë se a zvogëlon mungesa e rrethanave rënduese efektin e sigurisë që do të minimizonte rastet e reja të abuzimit seksual, veçanërisht në rastet që përfshijnë të mitur.

Ngjashëm, shumica e aktgjykimeve me shkrim thjesht numërojnë faktorët lehtësues dhe rëndues pa vlerësim të mëtutjeshëm dhe më pas bëjnë referim standard në qëllimin e dënimit, që thonë se do të arrihet përmes vendimit. E shumta e rasteve nuk përfshijnë çfarëdo vlerësimi të rrethanave të përmendura ose ndikimin e tyre në vendimin e gjykatës, apo çfarëdo referimi lidhur me ashpërsinë e dënimit të zgjedhur në lidhje me kufizimet ligjore të caktuara për veprën specifike penale.¹⁷

Mungesa e arsytimit të duhur në aktgjykimet e gjykatave ku përfshihen rastet në të cilat janë zbatuar rrethana lehtësuese jo vetëm që shkel ligjin e aplikueshëm, por gjithashtu dështon ti shërbejë qëllimit të parandalimit.¹⁸ Kjo mungesë e arsytimit mund po ashtu të ndikojë në perceptimin e përgjithshëm të publikut lidhur me atë se si sistemi gjyqësor përgjigjet ndaj veprave penale specifike.

¹⁶ Përderisa nuk ekziston ndonjë komentari për KPK-në që elaboron mbi natyrën e rrethanave rënduese që do të duhej të ndikojnë në dënim, komentari në vijim i ligjit më parë të aplikueshëm, Ligji Penal i RFJ-së mund të shërbejë si udhëzues. Ljubisa Lazarevic: *Komentar i Nenit 8 të Ligjit Penal të Republikës Federative të Jugosllavisë*, Edicioni i 5^{të}, Beograd, 1995.

¹⁷ Shih Shqyrtimin e OSBE-së mbi Sistemin e Drejtësisë Penale: “*Krimi, Paraburgimi dhe Dënimi*” (prill 2003 – tetor 2004), faqe 67. E qasur me 16 korrik 2010 në http://www.osce.org/documents/mik/2004/12/3984_sq.pdf

¹⁸ Neni 34 i KPK-së thotë: “QËLLIMI I DËNIMIT. Qëllimet e dënimit janë: 1) Të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij dhe 2) Të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

OSBE ka vërejtur mungesë të udhëzuesve mbi dënime¹⁹ për ti ndihmuar gjykatave në vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese në vendimet mbi dënime. Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka ushtruar në mënyrë aktive rolin e vet për të ofruar arsytim shtesë në vendimet e veta mbi dënimet.²⁰ Kjo do të mund të lehtësohej përmes vendimeve të arsyetuara mirë kur ato përgjigjen në ankesa nga gjykatat më të ulëta.

Gjykatat më të ulëta nuk kanë qasje të lehtë në aktgjykimet e gjykatave të qarkut dhe të Gjykatës Supreme të Kosovës.²¹ Një bartje e tillë e njohurive ndërmjet gjykatave do të kontribuonte në një qasje të vazhdueshme për vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese kur merren vendime mbi dënime. Qëndrueshmëria në caktimin e dënimeve është një parim fundamental i drejtësisë. Pabarazia në dënimin e rasteve të ngjashme do të çonte në perceptim të padrejtësisë dhe zvogëlim të mëtejme të besimit të publikut në gjykata.

Përfundim dhe rekomandime

Mungesa e themelimit të jurisprudencës apo burimeve tjera për ti ndihmuar gjykatave rreth vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese i len gjykatat në Kosovë me pak udhëzues. Veç kësaj, rezultojnë në rrezik më të madh që rastet e ngjashme përfundojnë me rezultate shumë të ndryshme, sepse gjyqtarët kanë mundësi të kufizuara për të mësuar nga të tjerët praktikatat për caktimin e dënimeve.

OSBE ka monitoruar një numër shembujsh kur aktgjykimet e gjykatave nuk vlerësojnë rrethanat lehtësuese dhe rënduese përkatëse në lidhje me krimin dhe të pandehurin. Shpesh ka arsytim të pakët për ndëshkimin nën dënimet standarde të autorizuara me KPPK. Mendimet shpesh zbulojnë një mungesë të kuptimit se si të vlerësohen rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Këto zbrazëtira ishin vërejtur në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor.

Lidhur me atë që u tha më lartë, OSBE në vijim rekomandon se si të përmirësohet sistemi gjyqësor në Kosovë:

- Gjyqtarët do të duhej ti referoheshin frazës “rrethana veçanërisht lehtësuese” dhe ti identifikojë faktet specifike të rastit kur kjo, siç është dhënë me Nenin 66 të KPK-së parasheh dënim nën kufirin standard ligjor;

¹⁹ Shih Shqyrtimin e OSBE-së mbi Sistemin e Drejtësisë Penale: “*Krimi, Paraburgimi dhe Dënimi*” (prill 2003 – tetor 2004), faqe 49 dhe 67. E qasur me 16 korrik 2010 në http://www.osce.org/documents/mik/2004/12/3984_sq.pdf.

²⁰ Neni 31(7), Ligji mbi Gjykatat e Rregullta (Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Nr. 21, 28 prill 1978) thotë që Gjykata Supreme e Kosovës “përcakton qëndrimet parimore dhe mendimet juridike mbi çështjet që kanë rëndësi për zbatimin unik të ligjeve nga ana e gjykatave në territorin e Krahinës.”

²¹ Në vitin 2002 dhe 2003, Qendra Juridike e Kosovës (QJK) në bashkëpunim me Fondacionin Kosovar për Shoqëri të Hapur, publikoi dy përmbledhjet e para të aktgjytimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës. Shih Shqyrtimin e OSBE-së mbi Sistemin e Drejtësisë Penale 1999-2005 “*Reforma dhe Shqetësimet e Mbetura*”, mars 2006, faqe 23 -24; E qasur me 16 korrik 2010 në http://www.osce.org/documents/mik/2006/03/18579_sq.pdf. Vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë publikuar nga QJK qysh prej “*Buletini i Praktikës Gjyqësore, Gjykata Supreme e Kosovës, janar-mars 2006*” që ishte publikuar në vitin 2007.

- Gjykata Supreme e Kosovës dhe gjykatat e qarkut do të duhej të ofrojnë mendime ligjore mirë të arsyetuara dhe udhëzime lidhur me dënime për të inkurajuar bartjen e njohurive ndërmjet gjykatave dhe zbatimin uniform të normave ligjore lidhur me dënime;
- Gjykata më të ulëta do të duhej ti ofrohej qasje më e lehtë në aktgjykimet e gjykatave të qarkut dhe Gjykatës Supreme të Kosovës;
- Avokatët dhe prokurorët publik do të duhej ti ndihmojnë gjykatave duke propozuar se cilat rrethana janë lehtësuese dhe cilat janë rënduese; dhe,
- Instituti Gjyqësor i Kosovës do të duhej të vazhdojë të ofrojë trajnime për gjyqtarë dhe prokurorë në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor mbi atë se si të vlerësohen rrethanat lehtësuese dhe rënduese lidhur me dënime, përfshirë këtu edhe trajnim që trajton dhunën seksuale ndaj të miturve.